

## **Takvaja – Devotshmëria\***

***Termi takva përdoret për të shprehur përpikërinë që tregohet në ndjekjen e urdhrave dhe këshillave të fesë dhe në largimin nga haramet dhe mëkatet.***

### **Përkufizimi**

Termin *takva*, i cili rrjedh nga rrënja *vikajeh*, që në aspektin etimologjik nënkupton “të ruhesh, të mbrohesh, të kesh kujdes, të largohesh, të respektosh, të jesh i dëgjueshëm, të jesh fetar, të ndjekësh me përkushtim, të frikohesh, të druhesh”, Sejjid Sherif el-Xhurxhani e përkufizon kështu: “Të ruhesh nga dënimi i Zotit duke e respektuar Atë. Kjo realizohet duke e ruajtur *nefsin* nga sjelljet për të cilat njeriu do të meritonte të ndëshkohej”.<sup>1</sup>

### **Përdorimi i këtij termi në Kur’an dhe Sunnet**

#### ***a. Në kuptimin e dëgjueshmërisë***

Termi *takva* dhe format tjera të derivuara nga rrënja e saj si *ittika*, *tekijj*, *etka*, *muttekijj* në Kur’an përmenden 285 herë. Në Kur’an dhe në hadithet e Pejgamberit a.s. termi *takva* ndonjëherë përmendet në kuptimin e tij etimologjik, kurse disa herë të tjera në kuptimin “të ruhesh nga dënimi i Zotit duke i ndjekur urdhrat e Tij dhe duke u larguar nga ndalesat e Tij”. Përgjithësisht pejgamberët u janë drejtuar ummeteve të tyre me fjalët: “*Kini frikë* (dënimet të) *All-llahut e jini të dëgjueshëm ndaj meje!*” (esh-Shu’ara, 26:108, 179).

Duke qenë se ai që është i dëgjueshëm ndaj Pejgamberit a.s. është i dëgjueshëm edhe ndaj All-llahut xh.sh. (en-Nisa’, 4:80), *takvaja* nënkupton dëgjueshmërinë ndaj All-llahut dhe ndaj Pejgamberit të Tij.

#### ***b. Në kuptimin e ruajtjes, mbrojtjes***

Kur Kur’ani flet për besimtarët si zotërues të *takvasë*, zakonisht aty flitet edhe për mbrojtjen e tyre nga dënimi i xhehenemit (ed-Duhan, 44:56; et-Tur, 52:18; el-Insan, 76:11); prandaj edhe besimtari kërkon nga All-llahu ta mbrojë nga dënimi i xhehenemit (el-Bekara, 2:201; Alu Imran,

---

\* Ky artikull është përkthim nga turqishtja e profesorit tim të nderuar në Bursa të Turqisë, dhe përbën zërin “*Takva*” në Enciklopedinë islame të Dijanetit të Turqisë: *İslam Ansiklopedisi*, Türkiye Diyanet Vakfı İslam Araştırmaları Merkezi (İSAM), Stamboll 2010, vëll. 39, f. 484-486. Fusnotat në këtë formë si dhe nëntitujt i kam shtuar unë, përkthyesi, R.N.

<sup>1</sup> Es-Sejjid Sherif el-Xhurxhani, *Mu’xhem et-Ta’rifat*, Kajro 2004, zëri “et-Takva”, f. 58-59.

3:191). Emërtimi i All-llahut me termin *ehlu't-takva* (el-Muddeththir, 74:56) nënkupton se Ai është mbrojtës dhe strehues i mirë për ata që e kërkojnë këtë prej Tij. Edhe shprehja “ruaj” në lutjen “*Na ruaj nga dënimi i zjarrit!*” (el-Bekara, 2:201; Alu Imran, 3:16, 191) dhe “ruajeni” te ajeti “*Ruajeni vetveten dhe familjen tuaj nga zjarri!*” (et-Tahrim, 66:6) vijnë nga e njëjta rrënjë.

### **c. Në kuptimin e frikës që lind nga respekti**

Fjala *takva* në Kur'an përmendet 17 herë (p.sh. shiko el-Bekara, 2:197; el-Maideh, 5:2; el-A'raf, 7:26; et-Teubeh, 9:108; Taha, 20:132). Komentuesit (*mufessirun*) klasikë të Kur'anit fjalës *takva* dhe formave urdhërore që dalin nga ajo kryesisht ia kanë dhënë kuptimin “Frikohuni All-llahut!” ose “Kijeni frikë All-llahun!”. Edhe pse kjo folje në vetvete përmban edhe kuptimin frikë, kjo nuk nënkupton druajtjen nga diçka e frikshme dhe e tmerrshme, porse shpreh druajtjen të mos ia lëndosh zemrën dikujt që e do, shpreh ndjeshmërinë e respektimit dhe përgjegjësisë ndaj Krijuesit. Në këtë kontekst, përkthimet si “Vetëdija për Zotin” ose “Vetëdija për përgjegjësinë ndaj Zotit”, që ofrohen për fjalën *takva*, na duket se i përgjigjen më mirë përmbajtjes së vetë termit. Frikën që e përmbajnë termet *takva* dhe *ittika* në fakt buron nga respekti dhe nderimi që njeriu e ndjenë karshi All-llahut xh.sh. Një ndjenjë e këtillë besimtarët i largon nga veprat e këqija e mëkatet dhe i nxit drejt veprave të mira e të këndshme. Në Kur'an dhe në hadithet e Pejgamberit a.s. kur flitet për frikën me rastin e fatkeqësive të ndryshme, të kijametit, të ringjalljes dhe të xhehenemit përdoren fjalë që burojnë nga termet *hauf*, *hashjeh*, *feza'*, *rahbeh*, *vexhel*, *ru'b*, *ishfak*. Në ajetet me kuptimin “*Mos kini frikë prej tyre, por prej Meje!*” (el-Bekara, 2:150; Alu Imran, 3:176) frika nga Zoti përmendet me termin *hauf* dhe *hashjeh*. Ndërkaq në ajetin 52 të sures 24, en-Nur, përmenden njëra pas tjetrës fjalët *hashjeh* dhe *ittika*. Që të gjitha këto tregojnë se në vija të përgjithshme *takvaja* është diçka ndryshe nga frika. Është me rëndësi të përmendet se Pejgamberi a.s. shpesh bënte *du'a*, lutje, me këto shprehje: “*O Allah, kërkoj strehim/mbrojtje te Ti prej Teje!*”<sup>2</sup> ose: “*Kërkoj mbrojtje tek All-llahu nga hidhërimi i Tij!*”<sup>3</sup> Sipas kësaj *takva* do të thotë të kërkojsh mbrojtje dhe strehë tek All-llahu xh.sh. nga hidhërimi dhe zemërimi i Tij. Në Kur'an kërkohej prej besimtarëve që ta ruajnë vetveten nga shejtani, nga fitneja (el-Enfal, 8:25), nga xhehenemi (Alu Imran, 3:131), nga kijameti (el-Insan; 76:11). Në këtë aspekt *takva* do të thotë të kërkojsh mbrojtjen e Zotit kundër çdo gjëje të keqe e të dëmshme. Kjo ndërkaq realizohet duke u ikur mëkateve dhe duke iu drejtuar punëve të mira. Për ruajtjen nga e keqja Kur'ani e përdor termin *hadher* (el-Munafikun; 63:4; et-Tegabun, 64:14).

### **Muttekij - i devotshmi**

Fjala *muttekij*, që nënkupton njeriun e devotshëm, në Kur'an përdoret 48 herë (p.sh. el-Bekara, 2:2; Alu Imran, 3:76; el-Maideh, 5:27; el-A'raf, 7:128; el-Enfal, 8:34). Në këto ajete përshkruhen vetitë e njerëzve të devotshëm (*muttekijun*). E kundërta e fjalës *takva* është *fuxhur*, ndërkaq e kundërta e fjalës *muttekij* është *fakhir* (esh-Shems, 91:8; Tirmidhiu, Menakib, 73; Ebu Davudi, Edeb, 111). Edhe fjala *tekij* (Merjem, 19:13, 18, 63) përdoret në kuptim të *muttekij* (i devotshëm). Edhe fjala *vak* ose *el-vaki* (er-Ra'd, 13:34, 37; el-Mu'min, 40:21) që nënkupton “mbrojtës, ruajtës” rrjedh nga e njëjta rrënjë.

<sup>2</sup> Muslimi, es-Salah, 222; Tirmidhiu, De'avat, 112.

<sup>3</sup> Tirmidhiu, Xhihad, 26.

Përmendja e shpeshtë e fjalës *takva* dhe e formave derivuese të saj në Kur'an, në raste të ndryshme dhe në forma të ndryshme, flet mjaftueshëm për rëndësinë që ka ky koncept në Islam. Për vlerën e *takvasë* në Kur'an theksohen këto aspekte: All-llahu është me ata që kanë *takva* (el-Bekara, 2:194; et-Teubeh, 9:36, 123); i mbron ata dhe u ndihmon; Ai i do ata që kanë *takva* (Alu Imran, 3:76; et-Teubeh, 9:4, 7); Ai është mik, i dashur, mbrojtës i të devotshmëve (el-Xhathijeh, 45:18). Takvaja në të njëjtën kohë është një koncept që ka të bëjë me *imanin* (besimin) dhe me zemrën. Ata që sillen me respekt ndaj Pejgamberit a.s. përshkruhen si njerëz të cilëve All-llahu xh.sh. ua kalit, ua përshtat ose edhe i sprovon zemrat e tyre për *takvanë* (el-Huxhurat, 49:3). Respektimi i vendimeve të All-llahut xh.sh. pa dyshim që buron nga *takvaja* që ata kanë në zemrat e tyre (el-Haxhixh, 22:37).

### **Takvaja buron nga imani**

All-llahu xh.sh. e frymëzon *takvanë* në *nefsin/zemrën* e njeriut (esh-Shems, 91:8). Pejgamberi a.s. duke shënjuar me dorën e tij në gjoks ka thënë: “*Takvaja* është këtu”<sup>4</sup>, por e ka bërë edhe këtë lutje: “O All-llahu im, jepja *nefsit* tim (zemrës sime) *takvanë!*”<sup>5</sup>. Me fjalën *takva* e zemrës nënkuptohet *imani* (besimi), *jakini* (bindja e paluhatshme), sinqeriteti dhe respekti i thellë ndaj All-llahut xh.sh. Në Kur'an theksohet lidhshmëria që ekziston midis *takvasë* dhe besimit (*imani*): “*Druhuni nga All-llahu po qe se jeni besimtarë!*” (el-Maideh, 5:11, 57, 88). Të jesh i devotshëm, me *takva*, është kërkesë e besimit. Të gjithë pejgamberët kanë kërkuar prej ummeteve të tyre të jenë të devotshëm, me *takva*. Për të gjithë ata që janë të devotshëm Kur'ani është një libër udhëzimi (el-Bekara, 2:2; Alu Imran, 3:138; el-Maideh, 5:46). Edhe arsyeja dhe ndërgjegjja kërkojnë të jesh i devotshëm (et-Talak, 65:10).

### **Takvaja dhe shpëtimi në të dyja botët**

Edhe nga aspekti që fjala *takva* nënkupton “ruajtjen dhe mbrojtjen”, ka një lidhje të ngushtë me kijametin, ringjalljen, xhehennemin, xhenetin dhe me jetën e amshueshme. Kur'ani flet se ata që janë të devotshëm do të kenë përfundim të mirë (Taha, 20:132; el-Kasas, 28:83; Sad, 38:49; ez-Zuhruf, 43:35). Një ardhmëri e mirë që u premtohet të devotshmëve ka të bëjë edhe me jetën e kësaj bote, mirëpo për të arritur fundin e lumtur duhet me qenë i durueshëm (el-A'raf, 7:128; Hud, 11:49). Rruga e arritjes së shpëtimit në këtë botë dhe në botën tjetër, që në Kur'an shprehet me fjalët *feuz* (sukses), *nexhat* (shpëtim) dhe *felah* (mirëqenie), varet nga të qenët i devotshëm, me *takva* (el-Bekara, 2:189; el-Maideh, 5:35, 100; ez-Zumer, 39:61; en-Nebe', 78:31). Zahireja (furnizimi) më e mirë për në botën tjetër dhe ajo që atje do të jetë më e dobishme është *takvaja* (el-Bekara, 2:197). Xheneti është përgatitur për të devotshmit (Alu Imran, 3:133; el-Hixhr, 15:45; ed-Duhan, 44:51). Në Kur'an thuhet qartë se ata që nuk kanë *takva* siç janë tiranët, zullumqarët, ngatërrestarët, ata që nuk ruhen nga kryerja e mëkateve dhe e punëve të këqija, do të dënohen në xhehennem.

### **Takvaja të ndriçon mendjen me dritën hyjnore**

*Takvaja* bën të mundur që All-llahu xh.sh. ta mësojë dhe ndriçojë robin e Tij (el-Bekara, 2:282; el-Enfal, 8:29). Një besimtari të devotshëm të cilit zemra i ndriçohet me një dritë hyjnore

<sup>4</sup> Muslimi, el-Birr, 32; Tirmidhiu, el-Birr, 18.

<sup>5</sup> Muslimi, Dhikr, 73; Nesaiu, Isti'adheh, 13.

(*furkan*), ka mundësinë të bëjë dallimin midis së mirës dhe të keqes, midis së vërtetës dhe të pavërtetës, midis sevapit (shpërblimit) dhe mëkatit; ai ik me kujdesin më të madh nga e ndaluara dhe mëkati. Edhe nxjerrja e mësimëve nga ngjarjet historike dhe sociale bëhet në saje të *takvasë* (el-Bekara, 2:66; Alu Imran, 3:138; en-Nur, 24:34).

## **Takvaja dhe virtytet morale**

Në Kur'an flitet edhe për lidhjen midis vlerave morale dhe *takvasë*. *Takvaja* prezantohet si një arsyesim shpirtëror për largimin nga mëkatet e të këqijat dhe për orientimin drejt të mirave dhe sevapeve. Kështu që *takvaja* lidhet ngushtë me faljen (el-Bekara, 2:189), me lidhjen farefisnore (en-Nisa', 4:1), me drejtësinë (el-Maideh, 5:8), me korrektësinë (el-Bekara, 2:177; ez-Zumer, 39:33), me fjalën e drejtë (el-Ahzab, 33:70), me mirënjohjen (Alu Imran, 3:123), me mëshirën (el-En'am, 6:155; Jasin, 36:45), me mirësinë (el-Bekara, 2:189)... Besimtari më i vlefshëm tek All-llahu xh.sh. theksohet të jetë ai që ka më shumë *takva*, që është më shumë i devotshëm (el-Huxhurat, 49:13) dhe se petku i *takvasë* (el-A'raf, 7:26) është *takvaja* e zemrës e cila manifestohet në trupin dhe organet e besimtarit dhe e cila e mbron atë si një mburojë, parzmore. Edhe Pejgamberi a.s. ka thënë se ahlaku, morali i një besimtari të devotshëm, me *takva*, do të jetë vetëm i mirë dhe jo ndryshe.<sup>6</sup>

Forma më e përkryer e *takvasë* është të kesh një *takva* meritore ndaj All-llahut xh.sh. Mirëpo besimtari e ka të vështirë ta arrijë një *takva* të tillë. Për këtë arsye All-llahu xh.sh. në Kur'an na thotë: "*Andaj druhuni Perëndisë sa të mundeni, dhe dëgjoni, dhe përuluni dhe shpenzoni (prej pasurisë suaj) për të mirën tuaj. E ata që ruhen nga lakmia e madhe, janë fitues.*" (et-Tegabun, 64:16). Të devotshmin Kur'ani e quan *tekijj* dhe *muttekijj*, atë që është në një shkallë më të lartë të *takvasë* e quan *etka* (el-Huxhurat, 49:13; el-Lejl, 92:17). Kjo nënkupton se *takvaja* ka disa shkallë të saj. Besimtari është afër All-llahut xh.sh. aq sa ai ndjen respekt ndaj Tij.<sup>7</sup> Kush dhe sa është i devotshëm, këtë e di më së miri vetëm All-llahu xh.sh. (Alu Imran, 3:115; et-Teubeh, 9:44). Besimtari mundohet të bëhet i devotshëm, mirëpo nuk pretendon se është i tillë. Pejgamberi a.s. ka qenë njeriu më i devotshëm në mesin e njerëzve.<sup>8</sup> Në një hadith kudsij thuhet se *evlijatë* (të dashurit e Zotit) janë besimtarët me devotshmëri të lartë.<sup>9</sup>

## **Takvaja e tepruar shkakton vesvese**

*Takvaja* kërkon një përpikëri të thellë kur është në pyetje sevapi dhe gjynahu, *hallalli* dhe *harami*. Në Islam *hallallet* (të lejuarat) dhe *haramet* (të ndaluarat) janë të qarta. Mirëpo midis tyre ndodhen edhe gjëra të dyshimta. Ai që ruhet nga këto të dyshimta e ka ruajtur fenë dhe nderin e vet. Në një hadith Pejgamberi a.s. na porosit t'u ikim sendeve të dyshimta dhe t'u drejtohem atyre që nuk janë të tilla.<sup>10</sup> Edhe dy hadithet në vazhdim tregojnë se është kërkesë e *takvasë* që t'u ikim gjërave që nuk janë *hallall* dhe *mubah* (të lejuara): "*Mëkati (gjynahu) është ajo që nuk të lë të qetë dhe nuk të fle në zemër*"<sup>11</sup>, "*Fetvanë (përgjigjen) lype nga zemra jote*".<sup>12</sup>

<sup>6</sup> Tirmidhiu, el-Birr, 55.

<sup>7</sup> Buhariu, Menakib, 1; Muslimi, Fedail, 168.

<sup>8</sup> Buhariu, I'tisam, 27; Muslimi, Sijam, 74.

<sup>9</sup> Ebu Davudi, Fiten, 1.

<sup>10</sup> Buhariu, Buju', 3; Tirmidhiu, Kijameh, 60; Ebu Davudi, Buju', 3.

<sup>11</sup> Muslimi, el-Birr, 14; Tirmidhiu, Zuhd, 52.

<sup>12</sup> Ahmedi, *Musned*, II, 4; Darimiu, Buju', 2.

*Takvaja* kërkon që në radhë të parë të largohemi nga sendet e dyshimta kur janë në pyetje të drejtat e njeriut, prandaj edhe ndalohet gjykimi i dikujt me dëshmi të dyshimta.<sup>13</sup> Ruajtja nga sendet e ndaluara dhe të dyshimta ka rëndësi si për nga *haku* (e drejta) i Zotit ashtu edhe për nga *haku* i njeriut. Juristët islamë për shembull kanë thënë që nëse dikush bie në dyshim nëse namazin e ka kryer plotësisht ose jo, si kërkesë e *takvasë* ai duhet ta përsërisë atë namaz, mirëpo nëse bie në dyshim nëse i ka dikujt borxh ose jo, nuk ka nevojë që për çdo rast t'ia paguajë atij borxhin, pa ia kërkuar i zoti i tij.<sup>14</sup> Për mallrat që shiten nëpër tregje e shitore, nuk duhet hulumtuar nëse këto janë të vjedhura ose jo. Sepse sendet në bazë janë të lejuara (përveç nëse nuk dëshmohet e kundërta – R.N.); dhe ne duhet të kultivojmë mendim të mirë dhe pozitiv për shitësin. Mirëpo, në shtetet jo-islame është kërkesë e *takvasë* të interesohesh për artikujt që i blen në mos kanë elemente të dërrit ose të alkoolit. Të jesh i përpiktë kur është në pyetje ryshfeti, dhurata, vakëfi, autorizimi, trashëgimia, po edhe në raportet punëdhënës-punëmarrës, në shërbimet publike, në shkollë, në spital etj. është kërkesë e lartë e *takvasë*. E njëjta vlen edhe në raport me natyrën, rrugët publike, gjallesat tjera etj.<sup>15</sup> Edhe pse *takvaja* është një virtyt bazë, teprimi në këtë drejtim ndonjëherë mund t'u hapë rrugë dyshimeve dhe vesveseve. Kjo gjendje pastaj nuk ka lidhje me *takvanë*. Lidhur me këtë Muhammedi a.s. ka thënë: “Janë shkatërruar (mutenatti'unët): ata që e kanë tepruar në punët e fesë (duke i stërholluar gjërat dhe ndarë qimet katërsh)”.<sup>16</sup>

### ***Takvaja në tasavvuf (misticizmin islam)***

Asketët (*zahid*) dhe mistikët (*sufij*) e parë tregonin kujdes të veçantë në çështjet e druajtjes nga Zoti, në strehimin te Zoti dhe në largimin nga gjërat e dyshimta. Në këtë periudhë janë bërë disa përkufizime të *takvasë* dhe është diskutuar rreth formave të saj si dhe rreth rezultateve dhe dobive të saj. Sipas sufijve është kërkesë e *takvasë* që të mos harxhohen më shumë se që ka nevojë të mirat e kësaj bote të kategorisë mubah dhe hallall. Disa asketë e mistikë e kanë konsideruar pjesë të *takvasë* të mjaftuarit me më të paktat e këtyre të mirave. Sufijtë gjithnjë kanë parapëlqyer që për bazë ta kenë kujdesin dhe të kryejnë atë që është e përgjithshme dhe bazike si dhe t'u largohen gjërave të dyshimta. Ata kanë vepruar jo në bazë të asaj që është e lejuar, por në bazë të asaj që është më e mirë dhe më e vlefshme. Ata e kanë konsideruar mëkat në qoftë se një i ngritur në *takva* është sjellë sikur të ishte një njeri i rëndomtë.<sup>17</sup> Sipas sufijve *takvaja* që është pllakosur në zemër bëhet burim i të gjitha dijeve dhe bekimeve.<sup>18</sup> Pikërisht nga kjo arsye edhe ajetin i cili flet për rëndësinë e *takvasë* (en-Nisa', 4:31) ata e kanë quajtur “*kutbu'l-Kur'an*” (poli, shtylla e Kur'anit).<sup>19</sup>

Sufijtë janë unikë në mendimin se nxënia e njohurive të shëndosha fetare, arritja e *keshf*-it (zbulim, frymëzim fetar) dhe e *keramet*-it (mrekulli e njerëzve të ngritur shpirtërisht) është e mundur vetëm në saje të një jete fetare të mbështetur në *takvanë*. All-llahu xh.sh. nefsit (zembrës) ia ka frymëzuar edhe mëkatën edhe *takvanë* (esh-Shems, 91:8). *Imani* është lakuriq; tesha e tij është *takvaja*, stolisja e tij është *vera'*-ja (qëndrimi larg dyshimeve dhe gjërave të

<sup>13</sup> Ibni Maxheh, Mukaddimeh, 2.

<sup>14</sup> Ömer Nasuhi Bilmen, *Hukuki İslamiyye ve Istilahatı Fikhiyye Kamusu*, vëll. I, f. 314.

<sup>15</sup> Ebu Hamid el-Gazzali, *Ihja'u ulumi'd-din*, Kajro 1939, vëll. II, f. 99-154.

<sup>16</sup> Muslimi, Ilm, 7; Ebu Davudi, Sunneh, 5; Darimiu, Mukaddimeh, 19.

<sup>17</sup> El-Kelabadhi, *Kitabu't-te'arruf li medh'hebi ehli't-tesavvuf*, Kajro 1994, f. 84, 85, 97, 98; Ebu Talib el-Mekkij, *Çutu'l-kulub*, Kajro 1961, vëll. II, f. 529; Ebu'l-Kasim el-Kushejrij, *er-Risaleh el-Kushejrijeh*, Kajro 1989, f. 735.

<sup>18</sup> Muhammed bin Husejn es-Sulemij, *Tabekatu's-sufijeh*, Bejrut 2003, f. 438.

<sup>19</sup> Ebu Talib el-Mekkij, *po aty*, vëll. I, f. 281.

kota), kurse produkti i tij është dija, njohuria.<sup>20</sup> Sipas këtij kuptimi *takvaja* është një dritë hyjnore në zemrën e pastruar nga mëkatet. Në bazë të kësaj drite besimtari e sheh të keqen dhe mëkatin dhe largohet prej tyre, si dhe të mirën dhe të lavdëruarën dhe e ndjek atë.<sup>21</sup> Harith el-Muhasibiu takvanë e përkufizon kështu: “Ta dëgjosh All-llahun dhe të largohesh nga mëkatet nëpërmjet një drite që të vjen nga All-llahu”.<sup>22</sup> Sipas Ebu Bekir el-Verrakiut njeriu i ndriçon gjendjet e tij nëpërmjet dritës së bindjes (*jakin*) dhe në saje të kësaj drite ai arrin shkallën e të devotshmëve, zotëruesve të *takvasë*.<sup>23</sup> Muhammed el-Xheriri thotë se pa i stabilizuar gjendjet e *takvasë* dhe të *murakabesë* (vetëkontrollit) nuk mund të arrihen shkallët e *keshfit* dhe të *mushahedesë* (njohjes së plotë në saje të dritës hyjnore).<sup>24</sup>

### **Takvaja e jashtme dhe e brendshme në *tasavvuf***

Sufijtë kanë folur për dimensionet e jashtme/të dukshme dhe të brendshme/të fshehta të *takvasë*. *Takvaja* e brendshme përbëhet nga nijeti i mirë dhe sinqeriteti që ndodhet në zemër, kurse *takvaja* e jashtme përbëhet nga ndjekja e përpiktë e rregullave të fesë.<sup>25</sup> Sipas el-Muhasibiut *takvaja* e vërtetë e zemrës përbëhet nga kujdesi për ta arritur kënaqësinë (*rizanë*) e Zotit gjatë ibadeteve, kurse *takvaja* e trupit dhe e organeve përbëhet nga kujdesi ndaj anës formale të tyre.<sup>26</sup> Sipas Ibni Mesrukiut *takvaja* është rezultat dhe fryt i respektit dhe nderimit ndaj Zotit. Të tregosh respekt ndaj njerëzve është rezultat i respektimit të Zotit. Përmes këtij respekti njeriu e arrin vërtetësinë e *takvasë*.<sup>27</sup> Gjënë më të mirë që ia ka dhënë Zoti njeriut është *takvaja*; ndërkaq baza e *takvasë*, që është burimi i të gjitha virtyeteve morale, është *ihlasi* (sinqeriteti, çiltërsia).<sup>28</sup> *Takvaja* nënkupton moralin e bukur dhe kafshatën hallall<sup>29</sup>. *Tevekkuli* (mbështetja në Zotin), *rizaja* (kënaqësia me Zotin) dhe *sabri* (durimi ndaj të papriturave) që të gjithë janë tregues të *takvasë*.<sup>30</sup>

### **Shkallët e *takvasë* në *tasavvuf***

Ta ruash hallallin nga dyshimet është *takvaja* e njerëzve të rëndomtë (*avam*). Njerëzit e veçantë (*havass*) ndërkaq *takva* e quajnë të heqësh dorë nga ajo që është hallall dhe e cila i tejkalon nevojat e njeriut. Sipas disa sufijve *takva* do të thotë të heqësh dorë nga ajo që nuk është e domosdoshme. Sipas *arif-ëve* (gnostikëve) *takva* do të thotë që njeriu të ruhet nga gjithçka tjetër pos Zotit dhe në zemrën e tij t'i bëjë vend vetëm Atij.<sup>31</sup> *Muridi* (dervishi fillestar) duhet të jetë abstenues, në çështje të hallallit duhet ta ndajë qimen katërsh, mirëpo nuk duhet ta teprojë sa të kalojë në vesvese.<sup>32</sup> Sufijtë flasin për shkallë a nivele të ndryshme të *takvasë*. *Takvaja* e

<sup>20</sup> Ebu Talib el-Mekkij, *po aty*, vëll. I, f. 289; vëll. II, f. 375.

<sup>21</sup> Ebu Nasr es-Serraxh et-Tusij, *el-Luma'*, Bagdad 1960, f. 303.

<sup>22</sup> El-Harith ibni Esed el-Muhasibij, *er-Ri'ajeh li hukuki'l-lah*, Bejrut p.v.b., f. 48.

<sup>23</sup> Es-Sulemij, *po aty*, f. 227 ; el-Kushejrij, *po aty*, f. 279; Feriduddin el-Attar, *Tedhkiratu'l-evlija'*, Teheran 1346 h., f. 238.

<sup>24</sup> El-Kushejrij, *po aty*, f. 278.

<sup>25</sup> El-Kushejrij, *po aty*, f. 279; el-Attar, *po aty*, f. 495.

<sup>26</sup> El-Muhasibij, *po aty*, f. 47.

<sup>27</sup> Es-Sulemij, *po aty*, f. 241.

<sup>28</sup> Po ai, f. 300.

<sup>29</sup> Po ai, f. 108.

<sup>30</sup> El-Kushejrij, *po aty*, f. 279.

<sup>31</sup> Po ai, f. 278.

<sup>32</sup> Nexhmuddin Daje, *Mirsadu'l-'ibad*, Teheran 1365 h., f. 258.

njerëzve të rëndomtë ka të bëjë me largimin e tyre nga *shirku* (paganizmi) dhe *kufri* (mosbesimi), *takvaja* e njerëzve të veçantë është largimi nga mëkatet dhe të këqijat, *takvaja* e *evlijave* (të dashurve të Zotit) është afrimi te Zoti duke i bërë *vesile* (mjet, ndërmjetësues) veprat e tyre, kurse *takvaja* e pejgamberëve është duke ia referuar veprat e veta Zotit.<sup>33</sup> Njeriu i devotshëm, me *takva*, nuk e përziën *shirkun* me *tevhidin* (besimin në një Zot), *munafikllëkun* (hipokrizinë) me *imanin* dhe me *ihlasin*, haramin ose hallallin me të dyshimtën, *bidatin* (risinë në fe) me *ibadetin* (adhurimin) dhe punët e mira. Të jesh i zënë me *dhikër* (përkujtim të Zotit) nënkupton *takvanë* e gjuhës, të jesh i dëgjueshëm ndaj urdhrave të Zotit nënkupton *takvanë* e trupit, të mos lidhesh me askënd tjetër pos Zotit nënkupton *takvanë* e zemrës. Gazzaliu, i cili *takvanë* e përkufizon kështu: “dëlirja e zemrës së besimtarit nga të këqijat”, e ndanë atë pastaj më dysh: *Takvaja* themelore, bazike, që nënkupton largimin nga haramet dhe të këqijat dhe që është *farz* (e obligueshme) për çdokënd, dhe *takvaja* e avancuar e cila nënkupton largimin nga e lejuara dhe hallalli për t’u orientuar drejt më të mirës dhe më fisnikes. Kjo e dyta nuk është *farz*, porse *fazilet* (virtut).<sup>34</sup> Gazzaliu pohon se *takvaja* është një shkallë apo nivel i veçantë dhe më i lartësuar se *vera*-ja dhe se në Kur’an koncepti *takva* përdoret në kuptim të “*hashjetit* (druajtjes) dhe *haufit* (frikës)” (el-Bekara, 2:41), në kuptim të “*itaatit* (dëgjueshmërisë) dhe *ibadetit* (adhurimit)” (Alu Imran, 3:102) dhe në kuptim të “dëlirjes së zemrës nga mëkatet” (en-Nur, 24:52),<sup>35</sup> dhe thekson se për *takvanë* pesë organe janë shumë të rëndësishme e që janë: syri, veshi, gjuha, zemra dhe barku.<sup>36</sup> Mevlana Xhelaluddin er-Rumi thotë se *takvaja* e hap mendjen dhe horizontin e njeriut.<sup>37</sup> Në *tasavvuf takvaja* është pranuar edhe si një *mekam* (pozitë, status, shkallë).<sup>38</sup> *Takvaja* është një bazë për të cilën duhet të kenë kujdes në veçanti *muridët* dhe *dervishët*.<sup>39</sup> Sufijtë gjithashtu kanë tërhequr vërejtjen për nevojën që besimtari duhet të ruhet nga *takvaja* e vet. El-Muhasibiu kur flet për pseudo-fetarët të cilët pretendojnë se janë të devotshëm dhe me këtë mburren karshi të tjerëve duke i shikuar ata me përçmim, thekson se këta janë njerëz që i ka mashtruar shejtani, se të devotshmit e vërtetë nuk e shikojnë veten mbi të tjerët, po madje edhe më të ulët se ata.<sup>40</sup> Edhe Vasitiu e thekson të njëjtën gjë kur thotë: “*Takva* do të thotë që njeriu ta ruajë veten nga *takvaja* e vet”<sup>41</sup>

## **Takvaja në fikh (të drejtën islame)**

*Takvaja* është trajtuar nga aspekte të ndryshme edhe në lëmin e së drejtës islame. Përkrah detyrës së kryetarit të shtetit dhe të gjykatësit, *takvaja* është kërkuar vazhdimisht si një kriter edhe te dëshmia, te kujdestaria dhe te format tjera të garantimit të të drejtave të njerëzve nën termin e drejtësisë morale që nënkuptonte largimin nga mëkatet e mëdha, mos-insistimin në mëkatet e vogla dhe kryerjen e vazhdueshme të farzeve. Drejtësia është konsideruar si një virtut i cili siguron të qenët i devotshëm dhe fisnik. *Takvaja* është kërkuar edhe si një kriter të transmetuesit e haditheve, brenda termit drejtësi. Te vetitë më të rëndësishme që kërkohen për personin i cili do të dalë imam në namazet me xhemat, krahas njohjes së rregullave të namazit,

<sup>33</sup> El-Kushejrij, po aty, f. 282.

<sup>34</sup> Ebu Hamid el-Gazzalij, *Minhaxhu'l-'abidin*, Kajro 1954, f. 45.

<sup>35</sup> Po ai, *Ihjau...*, vëll. I, f. 25; II, f. 95; III, 42.

<sup>36</sup> Po ai, *Minhaxh...*, f. 40-89.

<sup>37</sup> Mevlana Xhelaluddin er-Rumi, *Mesnevi*, Stamboll 1963, vëll. I, 140.

<sup>38</sup> Es-Serraxhij, po aty, f. 7; el-Mekkij, po aty, vëll. I, f. 364.

<sup>39</sup> El-Kushejrij, po aty, f. 276, 735.

<sup>40</sup> El-Muhasibij, po aty, f. 561.

<sup>41</sup> El-Kushejrij, po aty, f. 289; el-Attar, po aty, f. 745.

leximit të drejtë të Kur'anit, përmendet edhe devotshmëria, *takvaja*. Edhe pse kjo radhitje në çështjen e përparësisë se kush do të dalë imam është pranuar gjerësisht, disa dijetarë së këndejmi kanë theksuar se ai që e lexon Kur'anin drejtë ka përparësi ndaj atij që i njeh mirë rregullat e namazit dhe se ai që është i devotshëm, me *takva*, ka përparësi ndaj atij që e lexon Kur'anin drejtë. I njëjti kriter është kërkuar edhe në disa çështje të së drejtës familjare.

Nga turqishtja:  
Rejhan Neziri